



## Viti 2015 – Viti Ndërkombëtar i Dritës

### Pse?

Duke proklamuar vitin 2015 – Vit Ndërkombëtar të Dritës, njihet rëndësia që ka drita për ekzistencën e jetës dhe zhvillimin e saj; rëndësia e njohjes së saj; dhe rëndësia e shfrytëzimit edhe më të madh të saj.

### Kush?

Në dhjetor 2013, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në seancën e 68, me propozim të UNESCO-s (Organizata për Arsim, Shkencë e Kulturë e Kombeve të Bashkuara), shpalli vitin 2015 – “Vit Ndërkombëtar të Dritës dhe të Teknologjive të Bazuara në Dritë”. Rezoluta në gjuhët zyrtare të OKB-së mund të gjendet [këtu](#).

### Si?

Viti Ndërkombëtar i Dritës do të bashkoj shumë palë të ndryshme të interesit, përfshirë institucionet shkencore, institucionet arsimore, institucionet teknologjike, shoqëritë përfituese dhe jo përfituese; në mënyrë që të arrihen sa më mirë qëllimet e theksuara më lartë.

Viti Ndërkombëtar i Dritës është miratuar dhe përkrahur nga shumë institucione ndërkombëtare shkencore dhe ka më shumë se 100 partnerë nga afër 100 vende të botës. Disa nga ta janë: Instituti Amerikan i Fizikës (AIP), Shoqata Amerikane e Fizikës (APS), Shoqata Gjermane e Fizikës (DPG), Shoqata Europiane e Fizikës (EPS).

Gjatë këtij viti, anë e mbanë botës, zhvillohen aktivitete të ndryshme, që të gjitha së bashku afrojnë realizimin e qëllimeve të kësaj ngjarjeje botërore. Institucionet shkencore dhe shoqëritë teknologjike të mëdha dhe të vendeve të mëdha për nga të arriturat kanë kalendar të pasur të ngjarjeve gjatë tërë vitit.

Departamenti i Fizikës (FSHMN, UP) për Vitin Ndërkombëtar të Dritës do të organizoj, së paku, dy ligjërata të hapura të cilat do të mbahen në fillim të majit dhe në fillim të nëntorit. Me këtë rast, ftojme të interesuarit, që deri më 30. 04. 2015, të paraqiten me kontributet e tyre në këto ligjërata në këtë adresë: [klinaku@uni-pr.edu](mailto:klinaku@uni-pr.edu).